



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:239300

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05737435

C.nr.297/19

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nderim Musa, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B..., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit N.V., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, me objekt kontesti, rimbursim dëmi, vlera e kontestit 3,835.00 Euro, jashtë seance, me datë **20.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia me numër C.nr.297/21, e paditëses B..., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit N.V., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, lidhur me çështjen rimbursim dëmi.

A r s y e t i m

Paditësja B..., me seli në Prishtinë ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurit N.V., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, për rimbursim dëmi.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore me datë 20.05.2024, në të cilën ka prezantuar vetëm i padituri, ndërsa paditësja nuk ka prezantuar. Meqenëse paditësja ftesën për seancë e kishte pranuar me rregull dhe mungesën nuk e kishte arsyetuar, kurse i padituri nuk ka propozuar që seanca të mbahet në mungesë të paditëses, gjykata padinë e paditëses e konsideroi të tërhequr.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 409 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.297/19, të datës 20.05.2024

Gjyqtari
Nderim Musa

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.